

Gjykata e Qarkut në Prishtinë.
P. Nr. P.23/08
3 mars 2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarët e EULEX-it, Tron Gundersen si Kryetar i Trupit Gjykues, Andrea Cruciani, Gjyqtar i EULEX-it dhe Zahid Gijonaj, si anëtare, në lëndën penale kundër të pandehurit.

Gani Gashi, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorit Publik Ndërkombëtar PP-KT 546-1/07, paraqitur në këtë Gjykatë me datë 14 nëntor 2007, me **Krime Luftë kundër Popullatës Civile**, në shkelje të Kodit Penal të Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, Neni 142, në lidhje me Konventën e Gjenevës mbi Mbrojtjen e Civilëve në Kohë Luftë (Konventa e Gjenevës IV) neni 3 dhe 147 dhe Protokollin II për Konventat e Gjenevës, neni 4.

Pas gjykimit kryesor i mbajtur me dyer të hapura me datë 3, 4, 10, 25, 26 shkurt 2009 dhe 3 mars 2009 me praninë e të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës Fazli Balaj dhe Prokurorit Publik të Eulex-it Jens Christensen, dhe pas shqyrtimit për marrjen e vendimit dhe votimit të mbajtur me 3 mars 2009 shqiptoi dispozitivin e aktgjykimit (vendimit) si në vijim:

AKTGJYKIM

I akuzuari Gani Gashi, emri i babait [REDAKTUAR], lindur me datë [REDAKTUAR], në fshatin Komoran ku ai jeton tani, i martuar, 4 fëmijë, gjendje financiare të varfër, Shqiptar Kosovar, në paraburgim prej datës 16 gusht 2007 deri me datë 16 nëntor 2007 dhe në arrest shtëpiak prej datës 16 nëntor 2007,

shpallet

FAJTOR

për:

- a. Vrasje me dashje të [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] person civil, me datë 12 korrik 1998, duke e qëlluar atë në kurriz me një armë zjarri ndërsa [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] ishte i ulur në makinën Fiat, në rrugën mes fshatit Komoran/e dhe fshatit Kishnarekë/Kisna Reka në komunën e Gllogovcit/Glogovac, Kosovë dhe për pasojë të këtyre të shtënave [REDAKTUAR] O [REDAKTUAR] vdiq;

- b. Vrasje me dashje në tentativë e Sh [REDACTED] O [REDACTED] person civil, me datë 12 korrik 1998, duke qëlluar atë në kokë me armë zjarri ndërsa Sh [REDACTED] O [REDACTED] ishte i ulur në makinën Fiat në rrugën mes fshatit Komoran/e dhe fshatit Kishnarekë/Kisna Reka në komunën e Gllgovcit/Glogovac, Kosovë.
- c. Cënim i integritetit trupor dhe shëndetit të H [REDACTED] O [REDACTED] dhe S [REDACTED] O [REDACTED], me datë 12 korrik 1998, duke qëlluar ata me armë zjarri ndërsa H [REDACTED] O [REDACTED] dhe S [REDACTED] O [REDACTED] ishin të ulur në makinën Fiat në rrugën mes fshatit Komoran/e dhe fshatit Kishnarekë/Kisna Reka në komunën e Gllgovcit/Glogovac, Kosovë.

Me këto veprime, Gani Gashi ka kryer veprën penale të Krimeve të Luftës kundër popullatës civile, në shkelje të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (KP RSFJ) neni 142, neni 19, pika b, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59, lexuar me rregullat e ligjit ndërkombëtar në kohë lufte, konflikte të armatosura, ose pushtim, përkatësisht Konventa e Gjenevës mbi Mbrojtjen e Civilëve në kohë lufte (Konventa e Gjenevës IV) neni 3 dhe 147 dhe në shkelje të Protokollit II të Konventës së Gjenevës, Neni 4.

Për këtë arsye, i akuzuari Gani Gashi,

Në pajtim me nenin 38 të KPPK-së

DËNOHET

Me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burg.

KËRKESË PËR DËMSPËRBLIM

Nuk janë paraqitur kërkesa për dëmshpërblim.

SHPENZIMET

I akuzuari Gani Gashi duhet të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale.

Meqënëse të dhënat e shumës së shpenzimeve mungojnë, do të merret një vendim i ndarë mbi shumën e shpenzimeve.

ARSYETIMI

1. Historiku Procedural.

Aktakuza është ngritur me datë 14 nëntor 2007 dhe konfirmuar me datë 18 janar 2008 nga Gjyqtari Ndërkombëtar për Konfirmimin e Aktakuzës Timothy Baland. I pandehuri ka qenë në paraburgim prej datës 16 gusht 2007 deri me datë 16 nëntor 2007, zëvendësuar pastaj me arrest shtëpiak prej datës 16 nëntor 2007 deri në përfundim të gjykimit.

2. Përmbledhje e provave të paraqitura

Gjykata ka dëgjuar dëshminë e dëshmitarëve/palëve të dëmtuara në vijim: Agim Obrija (3 shkurt), F [redacted] O [redacted] (10 shkurt), H [redacted] O [redacted] (3 shkurt), B [redacted] O [redacted] (10 shkurt), S [redacted] O [redacted] (3 shkurt), A [redacted] R [redacted] (4 shkurt), Xh [redacted] N [redacted] (10 shkurt), I [redacted] B [redacted] (10 shkurt), H [redacted] H [redacted] (10 shkurt), T [redacted] Gj [redacted] (25 shkurt), I [redacted] B [redacted] (25 shkurt), M [redacted] V [redacted] (26 shkurt), F [redacted] I [redacted] (26 shkurt), dhe vetë i pandehuri (3 mars). Të gjithë, përveç Z V [redacted], janë thirrur nga Prokurori si dëshmitarë të mbrojtjes gjatë gjykimit kryesor. Trupi Gjykues ka konsideruar dhe bashkangjitur procesverbalit dokumentet e paraqitur në vijim:

- a. Prova 1, raporti i autopsisë dhe procesverbali i hetimit të jashtëzakonshëm të S [redacted] O [redacted]
- b. Prova 2 raporti që shpjegon shprehjet në Latinisht të përdorura nga doktor T [redacted] G [redacted] në raportin e tij. (fashikulli 21)
- c. Prova 3 raporti mjekësor i Sh [redacted] O [redacted] (fashikulli 21)
- d. Prova 4 raporti mjekësor i datës 12. 08. 00 për S [redacted] O [redacted] (fashikulli 28)
- e. Prova 5 çertifikatë vdekjeje e I [redacted] O [redacted] (fashikulli 28)
- f. Prova 6 fotografitë e ulëses (fashikulli 24) dhe raporti i datës 01.11.07 i oficerit të policisë I K [redacted], riezaminimi i ulëses së pasagjerit (fashikulli 25)
- g. Prova 7 fotografi e rrobave të viktimës (fashikulli 27)
- h. Prova 8 fotografi nga ajri e vendngjarjes (fashikulli 29)
- i. Prova 9 raport i ekzaminimit të mbështetëses së kokës i datës 25.02.09 nga oficeri i policisë F [redacted] I [redacted]
- j. Prova 10 mbetje të metalit nga mbështetësja e kokës, 2 qese plastike.
- k. Prova 11 mbështetësja e kokës

A [redacted] O [redacted]

A [redacted] O [redacted] ka dëshmuar përpara trupit gjykues me datë 3 shkurt. Ai tha se pas fillimit të luftës, shtabi i UCK-së në fshatin Komoran ku jetonte familja e tij ka urdhëruar banorët e fshatit të largohen nga shtëpitë e tyre sepse jeta e tyre ishte në rrezik. Ata duhej të shkonin në fshatin Kishnareka ku ai kishte të afërm.

Komoran Nr 1 ishte nën kontrollin e forcave serbe në kohën kur ka ndodhur incidenti. Fshati i dëshmitarëve ishte nën kontrollin e UCK-së në kohën e incidentit. Forcat serbe ishin të

vendosura në qendrën e Komoranit dhe në Qukë, Zabelli Nalt që quhej edhe Komoran 3. Kishnareka dhe Nekofci ishin gjithashtu nën kontrollin e UCK-së.

Me datë 12 korrik 1998, rreth mëngjesit kur forcat serbe nuk ishin në gjendje të vërenin fshatarët nga distanca ku ishin të pozicionuar, familja O [redacted] ka udhëtuar me makinë drejt shtëpisë së tyre në Komoran për të marrë disa sende personale. Makina ishte një Fiat Croma, ngjyrë gri metalike. A [redacted] O [redacted] ishte shoferi, babai I [redacted] dhe Sh [redacted] nipi, ishin të ulur përpara. Nëna [redacted], vëllezërit F [redacted], E [redacted], S [redacted] dhe djali i A [redacted], Sh [redacted] 6 vjeç ishin të ulur prapa në makinë. Kishte edhe disa familje të tjera në fshat dhe gjithashtu I [redacted] B [redacted] me disa kushërinj të dëshmitarëve R [redacted] dhe A [redacted] O [redacted]

Në atë kohë, I [redacted] B [redacted] ishte përgjegjës për fshatin. Shtabi i UCK-së ka informuar I [redacted] se fshatarët që ishin kthyer në shtëpitë e tyre duhej të informoheshin se ata duhej të shkonin dhe të hapnin istikame gjatë natës; kështu që I [redacted] ka shkuar në shtëpinë e dëshmitarit, ka folur me I [redacted] i cili ka thënë se dy djem të tij do të hapnin istikame. Familja O [redacted] ka vënë sendet në makinë dhe rreth orës 8:10 dhe 8:30, kjo do të ishte koha kur serbët nuk do të ishin në gjendje të shihnin ata nga pozicioni i tyre, kanë marrë rrugën e kthimit me makinë. Nuk ishte errësirë dhe ata nuk kishin ndezur dritat e makinës. Gjatë kthimit, A [redacted] ishte duke vozitur, I [redacted] dhe Sh [redacted] ishin të ulur përpara, Sh [redacted] ishte ulur në prehrin e I [redacted]. Gjithë personat e tjerë në makinë ishin të ulur prapa në makinë. F [redacted] pas vozitsit, në anën e majtë dhe afër derës, dhe pas F [redacted] ishte ulur B [redacted]. Pastaj S [redacted] dhe nëna H [redacted] në anën e djathtë afër derës me Sh [redacted] në prehrin e saj.

Rreth 200-300 metra më larg ndodhet një përru i vogël dhe një lloj kroi. Është një pozicion i fshehur me drurë të lartë. Shpejtësia e makinës ishte rreth 30-40 km në orë. Kur kanë arritur tek prroi ata kanë parë dy persona dhe i pari po vraponte. Ata ishin të veshur me uniforma ushtarake të UCK-së. Personi që vraponte ishte Gani Gashi. Ai mbante një armë automatike dhe ai bëri një gjest me dorë që tregonte se ata duhej të ndaleshin. A [redacted] ka menduar se ata po i paralajmëronin ata për diçka, ndoshta për forcat serbe, kështu që ai ka frenuar menjëherë dhe motorri është fikur. Dëshmitari ka hapur dritaren në atë moment dhe ka njohur Gani Gashin dhe Xh [redacted] N [redacted] Xh [redacted] ndodhej 5 apo 6 metra ndoshta 10 metra larg prapa. Ata të dy ishin të veshur me uniforma të UCK-së dhe mbanin pushkë AK-47, Ganija kishte kaluar prronin.

A [redacted] O [redacted] ka hapur dritaren dhe ka thënë: "Mirëmbërëma kojshi". Ai u përgjigj: "Mos thuaj, Mirëmbërëma kojshi". Kush është në makinë?" Në atë moment, ai drejtoi armën e tij në tëmthin e kokës së dëshmitarit dhe dhe pyeti: "Ku po shkon?" A [redacted] i tha: "Ti e di se po qëndrojmë me djemtë e tezes sime në Kishnarekë." Ai pyeti: "Ku keni qenë?" A [redacted] i tha se kishin qenë në shtëpi për të marrë disa sende. Ganija urdhëroi Xh [redacted] N [redacted] të thërrasë Komandantin M [redacted]. Ganija tha se Komandanti kishte thënë se ata nuk mund të shkonin në atë drejtim. Ganija pyeti dëshmitarin: "Kush është në makinë me ju?" edhe pse ai mund të shihte shumë qartë se kush ishte në makinë. Nuk ishte aq errësirë sa për të mos parë. A [redacted]

iu përgjigj se në makinë ishin, aid he babai, nëna, dy fëmijë dhe vëllezërit e tij. Xh [redacted] N [redacted] u largua për të thirrë Komandantin. Kur Xh [redacted] N [redacted] u largua, Gani Gashi përdori fjalë kërcënuese dhe tha: “Oh, ju kam kërkuar të gjithëve së bashku për një kohë të gjatë”. Pastaj ai shkoi pas makinës dhe filloi të shante dëshmitarin dhe familjen e tij. Ai mbushi armën e tij dhe filloi të shtënte nga pozicioni i tij pas makinës. Të gjithë personat në makinë kthyen kokën dhe për këtë arsye S [redacted] mbijetoi. U qëlluan dy apo tre të shtëna. Babai i A [redacted] I [redacted] u qëllua nga dy plumba. Nëna e tij u plagos në buzë, vëllai S [redacted] u qëllua në shpatull dhe Sh [redacted] 6 vjeç u qëllua në kokë ndërsa kthehej nga pas.

Pas të shtënave, I [redacted] u rrëzua në prehrin e A [redacted] Vëllezërit, S [redacted], E [redacted] dhe F [redacted] u përpoqën të jepnin ndihmë sepse A [redacted] po bërtiste: “ai ka vrrarë edhe Sh [redacted] O [redacted]”. Sh [redacted] ndodhej gjithashtu tek këmbët e I [redacted] Xh [redacted] N [redacted] u kthye menjëherë dhe detyroi Gani Gashin të largohej. Ai po i thoshte kolegut të tij: “Më le ti vras të gjithë sepse me sa duket nuk i kam vrrarë të gjithë. Ka kohë që pres për këtë”.

Kur Xh [redacted] N [redacted] mbërriti në vendin e ngjarjes, dëshmitari ishte në makinë duke u përpjekur të ndihmonte babain e tij dhe Sh [redacted]

Për pasojë të të shtënave, xhami i pasëm i makinës u thye plotësisht; kishte gjithashtu disa vrima, në veçanti, në ulësen përpara ku ishte i ulur I [redacted]

Dëshmitari deklaroi më tutje se Gani Gashi nuk kishte mundur ti vriste të gjithë sepse i ishte bllokuar arma. Ai e ka kuptuar këtë sepse xhami i pasëm i makinës ishte thyer dhe ai mund të dëgjonte çdo zhurmë shumë qartë. Gani Gashi ishte duke sharë dhe duke thënë se i ishte bllokuar arma.

Menjëherë, Xh [redacted] N [redacted] ka arritur në vendin e ngjarjes dhe ka marrë Ganiun me vete. Pastaj ka arritur Komandanti M [redacted]. Ai tha disa fjalë provokuese. Pasi që është ballafaquar me dëshminë e Xh [redacted] N [redacted] në gjykatë, dëshmitari ka deklaruar se ai mund të ketë gabuar në lidhje me personin që ka kapur dhe marrë me vete Ganiun. Mund të ketë qenë M [redacted] ai që ka ndalur Gani Gashin. M [redacted] pastaj është ulur në ulësen e parë dhe ka shkuar me viktimat për të marrë ndihmë mjekësore nga doktori i UCK-së I [redacted] B [redacted]. H [redacted] dhe vëllai i A [redacted] janë nxjerrë nga makina sepse nuk kishte vend dhe i kanë lënë në vendin e ngjarjes. G [redacted] O [redacted], një kushëri ndihmoi H [redacted]

Më vonë në dëshminë e tij në gjykatë, pasi që është ballafaquar me dëshmitarin N [redacted] A [redacted] ka deklaruar se Gani Gashi u ka thënë: “Fikeni motorrin dhe largohuni” Pastaj Gani Gashi ka qëlluar. Ky element thelbësor në ngjarje nuk ishte përmendur me parë në dëshminë e tij në gjykatë përpara trupit gjykues.

Makina ka mbërritur në shtëpinë e xhaxhait të doktorit, A [redacted] Sh [redacted] Doktorit doli dhe njerëzit që ishin në shtëpi dolën gjithashtu. Ata morën Sh [redacted] ndërsa ai po bërtiste dhe

qante dhe i ridhte shumë gjak. Njerëz të tjerë morën I [redacted] brenda për ta ekzaminuar nga doktori. Doktori tha se I [redacted] kishte vdekur dhe pastaj ai u kthye të ndihmonte Sh [redacted]

Sipas dëshmitarit nuk kishte armë në makinën e familjes O [redacted] në atë moment ditën kritike.

Motivi për këtë të shtënë nuk njihet nga dëshmitari sepse ata nuk pasur kurrë probleme. Megjithatë, përpara se të ndodhte kjo, Gani Gashi kishte një shikim armiqësor ndaj familjes C [redacted]. Kjo kishte filluar në vitin 1997 kur familja O [redacted] kishin pasur një problem me një familje tjetër. Ganiu ishte i zemëruar me familjen O [redacted] të cilët kishin pasur një zënkë me familjen e H [redacted] N [redacted] M [redacted] është nipi i N [redacted].

Dëshmitari deklaroi gjithashtu se kishin ardhur njerëz duke u përpjekur që të pajtonin familjen C [redacted] por me sa dinte ai ata nuk ishin dërguar kurrë nga Gani Gashi por kishin ardhur vetë.

Ai sqaroi në fund se arsyeja pse ai nuk kishte raportuar këtë incident në polici deri në vitin 2006 ishte sepse ai kishte pritur që komandantët ushtarakë të merrnin masa kundër Gashit. Familja e Gani Gashit e kishte kërcënuar atë dhe familjen e dëshmitarit.

H [redacted] O [redacted]

Dëshmitarja pohoi dëshminë e A [redacted] O [redacted] duke dhënë të njëjtin informacion si A [redacted] dhe për këtë arsye trupi gjykues nuk e konsideron të nevojshme të përmbledhë më gjatë dëshminë e saj. Ajo ka dëgjuar tre të shtëna dhe një plumb e goditi në buzë. Ajo humbi dëgjimin në një vesh.

A [redacted] R [redacted]

A [redacted] R [redacted] është një antropolog ligjor, aktualisht shef i zyrës së EULEX-it për Personat e Humbur. Ai ishte i pranishëm gjatë autopsisë së bërë me datë 31 dhjetor 2007. Me ndihmën e fotografive dhe një model skeleti, dëshmitari spjegoi trupit gjykues me datë 4 shkurt (fq 4-11 e procesverbalit) se cila nga kockat të dëmtuara nga plagët mund të japin përafërsisht orën e vdekjes. Plagët që ata përcaktuan gjendeshin në anën e majtë të krahavorit, Një zonë ishte thyer nga një impact me shpejtësi të lartë.

Nga fotografitë (8 dhe 9) të kockave të mbledhura nga autopsia, ka fotografi portret që korrespondojnë një impakti të një predhë me shpejtësi të lartë, karakteristike e plagëve të shkaktuara nga armë zjarri. Në fotografinë 17 mungojnë pjesë të kockës së brisë. Edhe kjo është rezultat i një impakti me shpejtësi të madhe shkaktuar nga një predhë me shpejtësi të madhe. Është me saktësi zona në anën e dorës së majtë, që përputhet me dëmin e shkaktuar nga një impact me shpejtësi të lartë, me shumë gjasa një e shtënë me armë. Gjatë autopsisë ata mundën të përcaktojnë pikën e hyrjes të plumbave, që ishin nga prapa. Kjo ishte e mundur sepse nga mënyra se si reagon kocka ndaj presionit të tillë si impakti me shpejtësi të lartë përcaktohet se si do të thyhet ajo kockë. Në zonën e dëmtuar, janë të kthyera dhe në

vendin e presionit në këtë zonë të veçantë do të thotë se ka më shumë dëmtim në pikën e daljes sesa të hyrjes. Pra, përse i përket hyrjes ata mund të përcaktojnë përafërsisht trajektoren, që do të thotë se e njëjta predhë ka dalur përafërsisht diku jashtë kockave. Shkarkimi i energjisë kinetike ka thyer kockën. Mjeku Ligjor dyshon se plumbi ka depërtuar përmes zonës së butë të kërcit, një zonë pa kocka. Pra, ata përcaktuan se kjo ishte një plagë depërtuese tejkaluere që ka hyrë nga prapa, në një kënd të vogël nga e majta duke dalë në anën e djathtë menjëherë mbi qendër¹.

Pika e hyrjes së këtij plumbi mund të thuhet se ishte qafa apo kraharori afër damarëve të qafës. Ka mundësi të ketë pasur me shumë se një plumb.

Dëshmitari deklaroi se ata kishin mbledhur të gjitha kockat, vetën disa gishta nga dora dhe këmbët mungonin.

Përfundimet e autopsisë janë se individi është qëlluar nga të paktën një predhë që është përcaktuar. Kjo nuk përjashton të tjerat të mundshme.

Gjithashtu zona e fytyrës është dëmtuar nga një lloj plage që ka shpërbërë një pjesë të fytyrës. Gjithashtu ka dëmtuar një pjesë të nofullës; pra ka pasur dëmtime në fytyrë dhe në nofull. Megjithatë mjeku ligjor nuk ka mundur të përcaktojë çfarë lloj force ka shkaktuar këtë plagë. Është e nevojshme të thuhet se kockat e fytyrës janë të imëta dhe delicate pra një impact relativisht i vogël në atë zonë mund të shkaktojë thyerje të rënda. Këto plagë kishin tiparet e plagëve të shkaktuara gjatë kohës së vdekjes. Mund të jenë shkaktuar nga një lëvizje apo rrëzim.

Ulësja dhe rrobat, këmisha dhe xhaketa, kishin shenja shumë të qarta të një hyrje që janë karakteristike të hyrjes së predhave. Ata nuk ishin në gjendje të shihnin dëmtime të ngjashme në dalje por duke pasur parasysh kohën e vitit nuk mund të përjashtohet mundësia se këmisha ishte pjesërisht e hapur.

Duke analizuar ulësen e makinës, duke vënë modelin e skeletit në ulëse, dëshmitari tregoi vrimën dhe stofë të djegur e cila shihet të jetë një hyrje. Dalja është gjithashtu e identifikuar. Dëshmitari ka ekzaminuar ulësen nga ana ballistike duke identifikuar një pikë dalje. Kjo është shumë e nevojshme sepse jep trajektoren si gati identike me atë në kocka. Në lidhje me frakturat e kafkës, dëshmitari nuk ishte në gjendje të përcaktonte forcën por ë përgjithësi dhe meqënëse kockat e fytyrës janë kaq delicate, një impakt nga një predhë do të kishte shkaktuar më shumë dëm sesa është treguar.

¹ Shih dëshminë e A. R. të datës 4 shkurt 2009, faqja 6 e procesverbalit të gjyqimit në gjuhën angleze.

Predha ka qëlluar pjesën prapa qafës, ka thyer dy kocka të vogla dhe brinjën dhe ka dalë mes dy brinjëve. Shpejtësia e predhës është zvogëluar, energjia kinetike shpërndahet kur qëllon kockat.

Xh [REDACTED] N [REDACTED]

Xh [REDACTED] N [REDACTED] ka dëshmuar përpara Gjykatës. Ai tha se gjatë luftës ai ishte ushtar i UCK-së, në detyrë ditën kritike, duke bërë aktivitetet e pikës së kontrollit. Ushtarëve të UCK-së u ishte thënë të mbronin punëtorët të cilët po hapnin pozicione për ushtrinë në rrugët në lagjen ku jetonte familja C [REDACTED]

Kur ai ka filluar detyrën e tij ishte plotësisht errësirë; ai ishte në detyrë me H [REDACTED] G [REDACTED], i cili është larguar pas pak duke u zëvendësuar nga Gani Gashi. Në një moment, ata kanë dëgjuar zhurmën e një makine që afrohej drejt pikës së kontrollit dhe pastaj kanë parë makinën që afrohej, me dritat e fikura, pa ditur se kush mund të gjendej në makinë. Shumë shpejt ata vendosën të ndalnin makinën dhe të shihnin kush gjendej në të. Kështu ata kanë bërë titur ndaj makinës që të ndalej dhe makina është ndalur përballë dëshmitarit. Nga pozicioni i tij, Z N [REDACTED] ka parë A [REDACTED] O [REDACTED] duke hapur dritaren. Gjatë këtyre çasteve, Gani Gashi ka shkuar në anën e dorës së djathtë të dëshmitarit.

A [REDACTED] O [REDACTED] ka pyetur: “Çfarë po ndodh, vëlla?” Pastaj dëshmitari ka ecur pas 4-5 metra. Gani Gashi ka shkëmbyer një fjalë me A [REDACTED] dhe në atë moment të veçantë, Gani Gashi ka urdhëruar dëshmitarin të shkojë dhe të informojë Komandantin i cili ishte me punëtorët, për të pyetur nëse kjo makinë duhej të lihej të vazhdonte rrugën apo jo. Dëshmitari nuk ka dëgjuar për çfarë po flisnin Ganiu dhe A [REDACTED] Ganiu ishte afër makinës, afër dritares dhe ata kanë folur me njëri tjetrin. Ganiu mbante një armë, një armë automatike ndërsa qëndronte tek dritarja. Pasi ai kishte ecur rreth 20 metra, dëshmitari ka dëgjuar zhurmën e gomave të makinës e cila sipas tij duhej të ishte makina që largohej shpejt nga vendi. Pastaj jai ka dëgjuar një të shtënë nga një armë automatike dhe vetëm një plumb ishte shtënë. Pastaj makina erdhi lart afër vendit ndodhej dëshmitari. Ajo iu afrua kaq shumë atij sa rrotat i prekën këmbët. Megjithatë dëshmitari vazhdoi të ngjitej drejt kodrës. Pasi që makina u ndal, ai dëgjoi derën e makinës që hapej. A [REDACTED] doli nga makina dhe pasi që u hap dera u ndezën dritat brenda makinës. A [REDACTED] bërtiti: “Ganiu na vrau”. Pas kësaj, ai dëgjoi edhe një të shtënë tjetër. Ajo ishte e shtënë më e butë, ishte një e shtënë revoleje. Pastaj dëshmitari mbërriti tek vendi ku ishin punëtorët por M [REDACTED] nuk ishte aty. Z N [REDACTED] zbriti kodrën dhe rreth 4-5 metra nga makina ai pa Komandantin M [REDACTED] duke ardhur nga vendi ku ishin punëtorët, mbi kodër, ku ishte makina. Ai pa M [REDACTED] që shkonte atje me nxitim duke u përpjekur me sukses që të fuste A [REDACTED] në makinë. Dëshmitari vërejti anëtarë të familjes që po dilnin nga makina. Ai pa nënën e A [REDACTED] të cilën e njeh shumë mirë dhe aty kishte edhe njerëz të tjerë. Edhe pse ishte shumë errësirë, dritat e vrendshme të makinës ishin të ndezura, dëshmitari vërejti edhe fëmijët në makinë. Pasi që M [REDACTED] arriti të fuste A [REDACTED] në makinë, makina u ngjit kodrës shpejt me dritat e ndezura. Ata morën personin e plagosur për ta dërguar në spital.

Kur e dëgjua e shtëna e parë, dëshmitari e kuptoi se nuk ishte askush tjetër që kishte shtënë përveç Gani Gashit.

Ai deklaroi se nuk është përpjekur fare të ndalojë apo të pengojë atë për të mos shtënë.

Më vonë, pas këtij incidenti, dëshmitari u takua me të dy, M [REDACTED] V [REDACTED] dhe Gani Gashin dhe Gani Gashi i tha Z N [REDACTED] të thonte se makina nuk u ndal dhe për këtë arsye ata qëlluan mbi makinë. Në atë moment, M [REDACTED] urdhëroi dëshmitarin: “Ju duhet të thoni se makina nuk u ndal dhe se ushtria vrau këtë njeri”.

Z N [REDACTED] nuk kishte dijeni nëse Gani Gashi mbante një armë tjetër përveç asaj automatike. Por nuk ka pa nëse A [REDACTED] posedonte armë sepse ishte errësirë.

Pas incidentit, M [REDACTED] informoi dëshmitarin se I [REDACTED] kishte vdekur. Ai u kthye nga fshati, u takua me të gjithë në lagjen B [REDACTED] dhe tha se I [REDACTED] tashmë kishte vdekur. Në atë çast Komandanti mori nga Ganiu armën e këtij të fundit. Pastaj Ganiu u dërgua diku në Shtab. Dy ose tre ditë më vonë, erdhën dy policë nga njësia e UCK-së e quajtur “Dove”. Ata ishin policia ushtarake. Ata morën Z N [REDACTED] dhe e shoqëruan në Shtabin e përgjithshëm për të dhënë një deklaratë për mënyrën si kishte ndodhur incidenti.

Z N [REDACTED] u tha se e vetmja arsye për të cilën Gani Gashi kishte qëlluar mbi A [REDACTED] ishte se ky i fundit kishte ikur pa marrë urdhrin nga ushtarët.

Ai tha panelit se të dy familjet, O [REDACTED] dhe Gashi kishin tentuar të influenconin atë mbi atë që do të thonte.

F [REDACTED] O [REDACTED]

Dëshmia e F [REDACTED] O [REDACTED] me datë 10 shkurt konfirmon dëshminë e dhënë nga vëllai i tij A [REDACTED] duke dhënë të njëjtin zingjir ngjarjesh, ashtu siç ishin spjeguar nga A [REDACTED] O [REDACTED]. Ai përmendi vetëm se në vendin ku qëndronin ushtarët nuk kishte pasur kurrë pikë kontrolli; nuk kishte pasur kurrë ushtarë në atë vend. Ajo ishte hera e parë që ata kanë parë ushtarë të UCK-së në atë vend. Ai deklaroi se ishte i ulur në makinë në anën e majtë, afër derës dhe se mund të shihte atë që po ndodhte.

B [REDACTED] O [REDACTED]

Dëshmitari dha para trupit gjykues të njëjtin zhvillim ngjarjesh të njohur nga trupit gjykues nga dëshmitë e dhëna nga vëllezërit e tjerë. Ai përmendi gjithashtu se duke pasur parasysh rrethanën dhe zhurmën, ai ka dëgjuar dy apo tre të shtëna dhe se kishte shumë tym në makinë.

I ■■■ B ■■■

Dëshmitari është nga Komorani dhe ka jetuar atje më përpara. Ai kujtohet se ditën kritike, një zyrtar i UCK-së i ka urdhëruar të informojë njerëzit në lidhje me hapjen e istikameve. Të gjithë banorët e fshatit janë larguar por disa ishin kthyer kohë pas kohe për të marrë ushqim, për tu kujdesur për bagëtitë etj. Ai deklaroi se kur nuk ka ushqim njeriu rrezikon edhe jetën për gjetur atë. Shumë njerëz u deklaruan vullnetarë por ishte detyrë e tij për të informuar të tjerët. Hapja e istikameve ishte e organizuar nga të gjitha strukturat nga UCK-ja dhe struktura politike dhe jo politike. Fshati i dëshmitarit ndahet në tre pjesë, Komoran 1,2 dhe 3 dhe ai ka vizituar vetëm lagjen e tij e përbërë nga 30 shtëpi. Ai ka folur me njërin prej djemve të familjes C ■■■. Ata thanë se do të ndihmonin në hapjen e istikameve pasi që të mbaronin punën e tyre në fushë me sa kujtohet dëshmitari. Istikamet ishin të mbrojtura nga ushtarë të UCK-së; Gani Gashi dhe Xh ■■■ N ■■■ ishin përgjegjës për mbrojtjen atë natë. M ■■■ V ■■■ ishte gjithashtu i pranishëm. Atë natë dëshmitari ka dëgjuar të shtëna. Ai nuk është i sigurtë nëse ka dëgjuar më shumë se një por më siguri ai ka dëgjuar një të shtënë.

T ■■■ Gj ■■■

Dr G ■■■ është mjek kirurg (neurolog) dhe punon në Prishtinë. Ai kujtohet se me 15 korrik 1998 ka ekzaminuar një fëmijë në klinikën Rezonanca. Pas skanerit me rreze lazer ai ka vërejtur një objekt të huaj në kokën e pacientit. Pas ekzaminimit, pacienti është operuar. Kur doktori ka hapur kafkën ka vërejtur objektin e huaj të ndalur në kockë dhe që pra nuk kishte depërtuar në tru. Ai kishte dëmtuar kockën duke ushtruar presion sepse kishte shpejtësi të ulët dhe depërtimi ishte në formë tangjenciale dhe jo direkte. Plumbi kishte depërtuar kockën dhe kishte mbetur në kokë pa dëmtuar trurin. Ai kujtohet se plumbi ishte në anën e majtë të kafkës.

Fatkeqësisht, doktori nuk ishte në gjendje të shihte pacientin pas ndërhyrjes por nga ajo që ai pa në kohën e operacionit mund të konkludohet se pacienti do të ishte në gjendje të funksiononte në mënyrë të duhur. Plumbi nuk kishte shpejtësi të lartë përpara se të qëllonte fëmijën sepse ka shumë gjasa që plumbi të ketë humbur shpejtësinë përpara se të godiste fëmijën.

Dëshmitari pranoi se ai kishte njohuri të kufizuara në lidhje me armët; megjithatë ai tha se plumbi i gjetur ishte i një kalibri më të madh, jo nga një pistoletë. Ata nuk kanë plumbin sepse duhej të largoheshin nga klinika.

H ■■■ H ■■■

Dëshmitari tha trupit gjykues se atij i kishin thënë se I ■■■ O ■■■ ishte vrarë. Gani Gashi me vëllezërit e tij kishte folur me të disa vite më vonë. Ai kërkoi që dëshmitari dhe babai i tij të shkonin tek A ■■■ për të parandalur atë që të mos raportonte rastin në polici.

I ■■■ B ■■■

I ■■■ B ■■■ është doktor. Në vitin 1998 dëshmitari kishte një klinikë të tij në Kishnarekë. Dëshmitari kujtohet se në korrik 1998, I ■■■ O ■■■ ishte sjellë tek ai, në shtëpinë e xhaxhait të tij ku ai qëndronte në atë kohë. Kur është sjellë I ■■■ O ■■■ ishte fillimi i mbrëmjes. Doktorin ka ekzaminuar atë; duke parë për shenjat e duhura, pacienti kishte iridët shumë të gjerë, ata nuk reagonin ndaj dritës, ai nuk kishte rrahje dhe nuk kishte shtypje gjaku. Doktorin filloi reanimacionin por pa sukses. Me sa i kujtohet pacienti kishte një plagë rreth qafës/fytit. Dëshmitari nuk ka vërejtur ndonjë plagë tjetër në trupin e të ndjerit; edhe pse ai ka zbërthyer dy butonat e sipërm të këmishës ndërsa i jepte ndihmën e parë. Megjithatë, ai ekzaminoi vetëm pjesën e përparme të qafës së tij. Ai nuk ekzaminoi nëse kishte plagë të tjera. Nga ekzaminimi i trupit të I ■■■ O ■■■ doktori ishte në gjendje të arrinte në përfundimin se vdekja ishte shkaktuar nga një armë zjarri.

Dëshmitari ka parë edhe fëmijën, Sh ■■■ O ■■■ Ai ka vërejtur se fëmija ishte duke vjellur dhe se kishte plagë në kafkë; ndoshta në anën e djathtë të kafkës. Doktorin thjesht pastroi plagën, dha fëmijës ndihmën e parë dhe pastaj drejtoi familjen për në spitalin e UCK-së në Likovc për trajtim të mëtejshëm.

Në atë moment kritik, doktori ekzaminoi bashkëshorten e I ■■■ O ■■■ Asaj i rridhte gjak nga goja por ka shumë gjasa që gjakderdhja të jetë shkaktuar nga thyerja e xhamit të dritares. I ■■■ B ■■■ tha se vdekja e I ■■■ O ■■■ ishte shkaktuar nga një armë zjarri.

M ■■■ V ■■■ (dëshmitar i mbrojtjes)

Z V ■■■ ishte komandant i një njësie në fshatin Komoran; përgjegjës për zonën 3 e quajtur Aktivi 3. Rreth qershorit 1998, fshati Komoran ishte evakuar për shkak të pranisë së afërt të forcave serbe. Në qershor dhe korrik 1998 kishte luftime gjithandej. Serbët ishin edhe në Komoran. Në atë kohë UCK-ja kishte rreth 40-60 ushtarë si dhe armë. Dy apo tre ditë përpara incidentit ata kishin filluar të hapnin istikame. Njerëzit që hapnin istikame ishin civilë; detyra e ushtarëve ishte të mbronin civilët.

Ditën kritike kishte plane për të hapur istikame. Njerëzit nga ajo lagje ishin thirrur për të hapur istikame nga ora 20:00 deri në orën 21:00. Komandanti i UÇK-së kishte emëruar dy ushtarë që do të mbronin civilët sepse zona ishte rrezikshme. Dëshmitari tha se nuk kishte dijeni atje do të ishin njerëz nga lagja. Rojeve u ishte thënë të ndalonin të gjitha lëvizjet dhe të raportonin ato tek komandanti dhe të linin njerëzit të kalonin nëse kjo do të ishte e nevojshme.

Pas pak kohe, u dëgjua një e shtënë dhe ai vrapoi drejt vendit ku kishte lënë rojet. Ishte errësirë dhe nuk mund të shihte asgjë. Kur arriti afër 20 metra, dera e makinës ishte e hapur, dritat brenda të ndezura kështu që ai pa njerëzit që ishin në makinë. Njëri nga personat që ishte duke dalur nga makina qëllloi një herë. Dëshmitari ka njohur ata persona; ishte A [redacted] O [redacted] me vëllezërit e tij.

E shtëna e dytë u qëllua nga A [redacted] O [redacted] me revole. Megjithatë, dëshmitari shtoi se ishte errësirë dhe se ai nuk mundi të shihte ndryshimin mes një pistolete dhe një revoleje. Ai ka parë armën në duart e A [redacted] sepse ai qëllloi me të. Ai është futur në mes të A [redacted] dhe G [redacted] dhe ka ndalur të shtënat.

Kur Z V [redacted] ka arritur në vendin e ngjarjes, rreth 15 metra nga makina, makina ishte e ndalur përpjetë në kodër, me dritat e fikura dhe njerëzit në makinë ishin duke dalur nga makina nga dera e majtë. A [redacted] O [redacted] dhe i pandehuri nuk ishin më larg se 15 metra nga unë. E shtëna e dytë u dëgjua pasi që dëshmitari kishte mbërritur atje, pra pasi që kishte parë A [redacted] dhe të pandehurit. Distanca mes Gani Gashit dhe makinës ishte 20 – 25 metra, prapa në anën e majtë. Dëshmitari u fut mes Ganiut dhe A [redacted] dhe u përpoq të merrte armën. Por ai nuk mori armën dhe vazhdoi të jepte ndihmë të plagosurve.

Në atë moment dëshmitari urdhëroi Ganiun të largohet dhe luti A [redacted] O [redacted] dhe vëllezërit e tij që të hynin në makinë, të largoheshin dhe të jepnin ndihmën e parë personave të plagosur. Për pasojë të kësaj plaje, plaku kishte vdekur dhe fëmija afër tij ishte plagosur.

Dëshmitari shoqëroi personat e plagosur në spitalin e improvizuar në Kishnarekë dhe u kthye përsëri në vendin e ngjarjes, duke kërkuar Gani Gashin, i cili u gjet në shoqëri të I [redacted] B [redacted] Gani Gashi ishte duke qarë dhe I [redacted] mendohej ta qetësonte. Pastaj dëshmitari pyeti Gani Gashin: « si arrite deri këtu ? » Ai tha: Makina nuk u ndal dhe në përpjekje për ta ndalur aksidentalisht tërhoqa këmbëzen e armës.’

Dëshmitari nuk u përpoq t’ia merrte armën Gashit gjatë incidentit por më vonë gjatë ditës ai ka çarmatosur personalisht Gani Gashin dhe e shoqëruar në makinë tek Komandanti F [redacted] Sh [redacted], në Shtab në Negrovc. F [redacted] Sh [redacted] mori armët dhe Gani Gashin në zyrat e tyre.

Dëshmitari nuk e dinte se kishte civilë në Komoran atë ditë. Zakonisht, çdo herë që një person donte të kthehej në shtëpinë e tij, ai kontaktonte më parë UCK-në.

Detyrat e ushtarëve të Uck-së në pikën e kontrollit ishte ndalimi i çdo lëvizje në atë rrugë dhe njëri prej tyre ishte i ngarkuar të shkonte tek komandanti dhe të informonte atë për çdo lëvizje të mundshme. Udhëzimet ishin dhënë gojarisht. Personat në këtë pikë kontrolli kishin bërë shërbimin ushtarak profesional dhe dinin se çafre duhej të bënin kur ndalej një makinë. Pra, procedura ishte që personi përgjegjës në pikën e kontrollit qëndron në këmbë dhe bën shenjën ndal, jo gojarisht. Ky person afrohet makinës dhe bën pyetje si psh kush janë ata dhe ku shkojnë. Pas verifikimit ata pyesin zingjirin e komandës nëse makina mund të vazhdojë rrugën apo jo. Shenja ndal dhe shenja paralajmëruese përsëriten 2 deri në 3 herë, hapi tjetër është të qëllohet me armë në ajër dhe hapi i fundit nëse makina nuk ndalet, është ajo që ka ndodhur në këtë rast, tha ai.

Megjithatë ai deklaroi, ata nuk duhet të qëllojnë kurrë mbi civilë të paarmatosur, si në këtë rast.

Dëshmitari deklaroi se familjet Gashi dhe O [REDACTED] nuk kishin pasur kurrë mosmarrveshje dhe ai mendon se aksidenti ishte i paqëllimshëm.

F [REDACTED] I [REDACTED]

Dëshmitari është një oficer i policisë së SHPK-së në Njësinë Ballistike të Forenzikës. Ai bëri ekzaminimin e ulëses së pasagjerit dhe mbështetëses së kokës dhe erdhi përpara trupit gjykues për të dëshmuar mbi rezultatet e këtij ekzaminimi. Janë bërë edhe analiza rentgen mbi mbështetësen e kokës të cilat kanë zbuluar praninë e copëzave të vogla metali.

Për më tepër, eksperti kishte vërejtur dy vrime në mbështetësen e kokës. Megjithatë, objektet që kanë bërë këto vrime nuk kanë depërtuar më larg.

Në vendet E1 dhe E2 eksperti ka gjetur copa metali. Këto ishin copëza shumë të vogla. Dëshmitari i ka hequr, ka bërë fotografi të tyre dhe i ka futur në qese plastike për teste të tjera. Ishte me siguri metal, me gjasa plumb, duke marrë parasysh ngjyrën e këtyre fragmenteve si dhe lëmueshmërinë e tyre. Megjithatë, nuk ishte në gjendje të specifikonte nëse ato ishin pjesë përbërëse të plumbit sepse ato nuk kishin karakteristika të tilla që t'i jepnin mundësinë atij për ti analizuar.

Eksperti ka vërejtur 3 vrime në këtë mbështetëse. Në vrimën e parë, e shënuar E1, ai ka gjetur një copëz metali apo fragment e cila ishte me siguri plumb. Por duhet të ekzaminohet më tej për tu konfirmuar. Vrima e dytë ishte një vrimë lehtësisht depërtuese por ekspertët nëse kjo ka depërtuar atë sepse përpara se ta priste atë ai ka futur një shufër metalike për të parë nëse kishte një vrimë dalëse. Kjo shufër metalike kishte një diametër prej 7 mm. Ajo nuk depërtoi

atë. Kur e preu, duke e ndarë në dy pjesë, nuk mund të thuhet nëse kjo ishte një vrimë depërtuese. Vrima e tretë 3 është një gërvishtje. Ekzaminuesit mund të thonë se dëmtimet kanë ndodhur si rezultat I objekteve me shpejtësi të lartë si dhe objekte që kanë energji të konsiderueshme. Ato mund të shkaktohen nga një predhë por ai nuk ishte i sigurt për këtë. Vrimat E2 dhe E3 nuk janë të lidhura me njëra tjetrën sepse ka një distancë mes tyre. Mundet që copat e metalit të kenë prejardhjen nga një pushkë sporti.

Përfundimet më raportin e tij janë:

"1. Provat e paraqitura: Një (1) ulësja e përparme e pasagjerit, ana e djathtë, përbëhet nga tre pjesë, pjesa ulëse, pjesa mbështetëse e mbuluar me stofë, ngjyrë kafe dhe pjesa e ulëses për mbështetësen e kokës prej gome apo sfungjer i presuar, ngjyrë e zezë e cila është objekt i ekzaminimit. Gjatë ekzaminimit fizik të kësaj pjese, përkatësisht pjesës së ulëses për mbështetjen e kokës në anën e pasagjerit, është vërejtur si në vijim:

- A. Një (1) vrimë në pjesën e sipërme në anën e majtë të pjesës së ulëses në fjalë për mbështetjen e kokës shënuar si E#1. Një (1) pjesë apo fragment metali ngjyrë gri e errët që ka gjasa të jetë (Pb) metal plumbi.*
- B. Një (1) hapsirë depërtuese në pjesën e poshtme në të majtë të mbështetëses së kokës së ulëses së shënuar me E#2 në të cilën janë gjetur katër (4) copa apo fragmente metali ngjyrë gri të errët që me gjasë është metal plumbi Pb. Por duhet të ekzaminohet me metoda kimike.*
- C. Një gërvishtje apo prerje në mes të pjesës së poshtme të mbështetëses së kokës të ulëses shënuar me E#3 në të cilën nuk kemi gjetur ndonjë copë metalike apo fragment.*

Këto dëmtime, vrima apo çarje në mbështetësen e kokës të ulëses së pasagjerit ka gjasa të jenë shkaktuar nga objekte metali me një shpejtësi apo forcë të konsiderueshme apo të lartë.

S [REDACTED] O [REDACTED]

S [REDACTED] O [REDACTED] spjegoi se gjatë incidentit ai ishte plagosur në pjesën e pasme të shpatullës së djathtë. Ai spjegoi se kishte qenë i ulur në ulësen prapa, i kthyer në anën e tij të majtë me qëllim që të shihte të pandehurin që shkonte nga pjesa e pasme e makinës. Ai është qëlluar nga një plumb që është konfirmuar gjatë operacionit të bërë në Itali në vitin 2000. Më tej dëshmitari deklaroi se plumbi nuk kishte penetruar, thjesht kishte hyrë në muskul. Ai nuk kishte plagën në pjesën e përparme të shpatullës. Plumbi ka gërvishtur, prerë por jo depërtuar. Pas operacionit ai ka parë copëzat e plumbave që ishin nxjerrë nga shpatulla e tij.

Dëshmitari kujtohet se gjatë të shtënave ai ka dëgjuar ndoshta 2-3 apo 4 të shtëna, ishte e vështirë të thuhej me saktësi.

Gani Gashi

Gani Gashi tha se kishte lindur në Komoran dhe se gjithmonë kishte jetuar aty.

Me datë 16 qershor 1998 ai u bë ushtar i UCK-së dhe shkoi në Shqipëri për të marrë armë. Kur u largua nga Komorani për në Shqipëri, në njësinë e tij ishin 7 ushtarë dhe kur u kthyen ata ishin 20. M [REDACTED] V [REDACTED] ishte komandanti dhe shef i njësisë në atë vend. Ata filluan të bëheshin një njësi e pajisur dhe po zbatonin ide si psh trajnim, hapje istikamesh; urdhrat vinin nga Komandanti i Njësisë, M [REDACTED] V [REDACTED]

Me datën 12 korrik 1998, i pandehuri i është kërkuar të ruajë pikën e kontrollit së bashku me Xh [REDACTED] N [REDACTED]. Pika e kontrollit të policisë në Komoran ishte e njohur mirë. Ata po ruanin rreth 30 njerëz të rinj që hapnin istikame me qëllim që të ndalonin avancimin e forcave serbe dhe për të mbrojtur popullatën civile. Ishte me siguri rreth orës 10:00 sepse nuk kishte asnjë mundësi që istikamet të hapeshin gjatë ditës. E gjithë zona mbi Quke ishte nën kontrollin e UCK-së. Komoran 1 ishte bosh por plot me trupa paraushtarake. Në Qukë ishin mbledhur trupa ushtarake dhe kishin nën kontroll të gjitha vendet në vijim. Komoran 2 dhe Komoran 3 përkatësisht lagjet Obrija dhe Berisha ishin boshatisur përpara se UCK-ja të fillonte hapjen e istikameve.

Dy nga personat që ishin evakuar nga këto fshatra ishin kthyer në fshat për të marrë sendet e tyre vetëm të shoqëruar nga UCK-ja. Ishte plotësisht e paligjshme të shkohej në ato vende pa lejen e Komandantit. Nëse jepej leja atëherë ushtarët pergjegjës për ruajtjen e vendit përkatës do të informoheshin për emrin e familjes që lejohej të kthehej.

Natën e incidentit, vendi ishte errësirë, aty gjendet një prockë dhe ka pemë dhe vegjetacion. Komandanti i njësisë urdhëroi ata që të jenë të kujdesshëm. I pandehuri dhe Xh [REDACTED] N [REDACTED] u mbështetën në murin e një shtëpie dhe rreth 20-30 minuta më vonë ata dëgjuan zhurmën e një makine që vinte në drejtimin e tyre në një rrugë të paasfaltuar. Armët, pushkë gjysëm-automatike AK 47, ishin të gatshme në rast urgjence. Ata u kuptuan me pak fjalë.

Ushtarët kanë bërë menjëherë këtyre personave dhe iu kanë kërkuar që të ndalen. Zakonisht gjatë luftës ata nuk do të ecnin njëri pas tjetrit por do të qëndronin paralelisht. Xh [REDACTED] N [REDACTED] ishte përballë rreth 4 metra përpara dhe u është dashur pak kohë për të dalë në rrugë dhe ishin duke bërë turrë që ata të ndaleshin. Makina nuk kishte drita ndezur dhe nuk kishte shenjë. Vozitsi nuk ishte duke vozitur shumë shpejt por ai ka ruajtur shpejtësinë dhe kaloi rreth 7 apo 8 metra më larg. I pandehuri gjendej 5 apo 6 metra pas Xh [REDACTED] N [REDACTED] dhe ka urdhëruar atë të kontrollojë makinën dhe të mos i lejojë të largohen para se të vinte Komandanti i njësisë për të verifikuar gjendjen. Në atë moment, i pandehuri qëndronte 10 metra larg; ai nuk mundur të dëgjojë ndonjë bisedë që ata kanë pasur. Xh [REDACTED] N [REDACTED] ka

zbatuar urdhrin dhe ka vrapuar tek Komandanti. Në atë moment, ai ka dëgjuar makinën që merrte shpejtësi dhe mendimi i parë ishte të qëllonte në ajër por fatkeqësisht rruganë atë vend është e keqe dhe ngjitet lart. Sikur të kishte qenë rruga e rrafshët ai do të kishte mundur të qëllonte në ajër. Makina ngjitej lart; ai po qëllonte dhe plumbi mun të ketë qëlluar makinën. Kur u hapën duert e makinës, vetëm atëherë ai pa se ishte një familje por akoma nuk e dinte nëse kishte vrrarë dikë. Në atë moment ai largua nga rruga rreth 3 apo 4 metra për në fushë dhe kur ishte në fushë ai tha: “Pse nuk u ndalët në kohë?” I pandehuri nuk i shau ata. Ai tha vetëm: “Ju do të jeni të përgjegjshëm për këtë para Zotit. Zoti do të ju dënojë.” A [redacted] doli nga makina dhe menjëherë qëlloi me armë një herë në drejtim të të pandehurit por plumbi i tij nuk e qëlloi atë. Dy vëllezërit e tjerë të A [redacted], S [redacted] dhe një tjetër vrapuan drejt të pandehurit. Ai mbante armën dhe rripi i armës ishte rreth mesit të tij. Dy vëllezërit e A [redacted] kapën tytën e armës së tij dhe u munduan t’ia merrnin atij. Përpara se komandant V [redacted] të arrinte në vendin e ngjarjes, i pandehuri pa A [redacted] duke qëlluar atë për të dytën herë, por ai nuk u qëllua. M [redacted] V [redacted] arriti të fuste A [redacted] në makinë dhe vëllezërit e tij u larguan dhe u futën në makinë. Më vonë, M [redacted] V [redacted] u kthye dhe informoi të pandehurin: “Gani, nuk duhet mërzhitesh shumë se I [redacted] na ka lënë”. Gashi ndihej keq kur mësoi se edhe djali ishte plagosur. Reagimi i të pandehurit ishte: “A është plagë e rëndë?”. Komandanti tha se ishte vetëm një gërvishtje në kokë por ai u ndie keq.

Gani Gashi tregoi se ai kishte mbajtur armën lart, jo drejt, kur kishte qëlluar. Ai kishte qëlluar vetëm një herë. Të shtënat në drejtim të tij ishin tre. Kur u qëllua, i pandehuri duhet të ketë qenë 10 metra larg. Ai dhe Xh [redacted] N [redacted] ishin katër metra larg njëri tjetrit. Kur u qëllua, Gashi ishte prapa makinës në anën e majtë.

Ai ka njohur A [redacted] vetëm kur janë ndezuar dritat e makinës. Ai ka mohuar se ka folur me A [redacted] përpara të shtënave. Nuk ka qenë fare e vërtetë ajo që Xh [redacted] N [redacted] ka thënë trupit gjykues se i pandehuri ka shkuar tek dritarja e makinës dhe ka folur me A [redacted]

Pas incidentit, komandantët e Gashit e kanë mbajtur atë në Negrovc gjatë një muaji dhe pastaj ka filluar ofensiva dhe ata kishin nevojë për ushtarë në të gjitha vendet, kështu që atij i është kërkuar të shkojë në front.

Gani Gashi tha trupit gjykues se i vinte keq për atë që ka ndodhur dhe se ishte një aksident.

Ai nuk kishte pasur kurrë më parë grindje me A [redacted] apo familjen e tij.

3. Gjetjet faktike dhe vlerësimi i provave

a) Gjetjet faktike

Bazuar në provat e paraqitura gjatë seancave të gjykimit, detajet e vlerësimit të provave të cilave gjenden më poshtë, trupi gjykues ka vertetur te çdo dyshimi të arsyeshëm se me datë

12 korrik 1998, Gani Gashi ishte roje në pikën e kontrollit në rrugën që shkon nga fshati Komoran në Kishnarekë. Ai ishte atje së bashku me Xh [redacted] N [redacted] të dy ushtarë të UCK-së, të dy të caktuar atje atë mbremje nga komandanti i tyre i drejtpërdrejtë M [redacted] V [redacted] për të mbrojtur civilët nga serbët ndërsa civilët hapnin istikame. Të dy ishin të veshur me uniforma.

Në apo rreth orës 20:30 makina e familjes O [redacted] Fiat Croma, u afrua pikës së kontrollit. Në makinë gjendej familja O [redacted] me tetë anëtarë; A [redacted] O [redacted] shoferi dhe afër tij ishte ulur I [redacted] O [redacted] me një fëmijë, Shpejtimi 6 vjeç ulur në prehrin e tij. Pas A [redacted] në ulësen prapa ishte ulur F [redacted] afër derës së majtë. Pas F [redacted] ishin të ulur B [redacted] pastaj S [redacted] dhe në anën e derës së djathtë nëna H [redacted] me fëmijën tjetër 6 vjeç, Sh [redacted] në prehrin e saj. Gani Gashi u bëri me shenjë që të ndalen dhe makina u ndal. A [redacted] O [redacted] shoferi, uli xhamin dhe përshëndeti. Gani Gashi pa ata që ishin në makinë dhe dërgoi Xh [redacted] N [redacted] të informojë Komandantin për kalimin e kësaj makine. Gani Gashi pati një bisedë me A [redacted] O [redacted] Gashi mbante një armë automatike AK 47 të drejtuar nga A [redacted] O [redacted] Gashi pastaj lëvizi dhe po qëndronte prapa makinës në anën e majtë, disa metra larg makinës. Pastaj makina u nis për arsye që nuk janë vertetuar. Gani Gashi qëllloi me armën e tij dhe plumbi depërtoi xhamin e pasëm të makinës. Xhami u thye dhe plumbi gërvishi pjesën e pasme të shpatullës së S [redacted] sepse ai po kthehej nga ana e majtë për të parë se çfarë po ndodhte. Ka shumë gjasa që fragmente nga xhami i dritares të kenë qëlluar nënën dhe ajo u plagos në buzë. Plumbi pastaj ka hyrë në pjesën e sipërme të ulëses së pasagjerit të I [redacted] O [redacted] ka dalë pak më poshtë në anën tjetër të ulëses dhe ka hyrë në kraharor (shpatull/qafë) të I [redacted] O [redacted] pastaj ka dalë nga pjesa e përparme e kraharorit të tij pak më poshtë përpara se të godiste Sh [redacted] në kokë në anën e majtë. Ai ishte i ulur në prehrin e Idrizit. Plumbi ka hyrë në kafkën e Sh [redacted] dhe mbetur në kockë.

Nuk ka prova – që të jenë vertetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm – se ka pasur më shumë se një plumb apo të shtënë. Dëshmitarët kanë dëshmuar se ka pasur më shumë se një të shtënë. Trupi Gjykues nuk mund të përjashtojë këtë, dhe mund të ketë pasur edhe të shtëna në ajër. Fragmentet e metalit në mbështetësen e kokës të makinës Fiat nuk është provë e plotë se janë shtënë më shumë se një plumb. Mund të jenë fragmente të një predhe tjetër apo të predhës që ka goditur I [redacted] O [redacted] megjithatë kjo nuk mund të vertetohet përtej dyshimit të arsyeshëm.

Dëshmitari ekspert, oficeri i policisë nga Njësia Ballistike e Forenzikës së SHPK-së, F [redacted] I [redacted] nuk ka mundur të përjashtojë as mundësinë se këto fragmente (me gjasë plumb) mund të kenë prejardhjen nga një pushkë sporti. Duhet të kujtojmë se kjo ulëse dhe makina kanë qenë të braktisuara për një kohë të gjatë në një fushë, pas incidentit.

Pasi që Gani Gashi qëllloi, makina u ndal përsëri. Të dy, Gani Gashi dhe M [redacted] V [redacted] thanë trupit gjykues se A [redacted] O [redacted] doli atëherë nga makina dhe mbante një armë dhe qëllloi. Trupi Gjykues nuk mund të konsiderojë se ky fakt është vertetuar siç duhet sepse të dy V [redacted] dhe

Gashi nuk mund të konsiderohen si plotësisht të besueshëm në dëshminë e tyre. Për më tepër fakti nëse A O në këtë moment ka qëlluar me armë apo jo nuk ka rëndësi themelore për vlerësimin e krimeve për të cilat Gashi akuzohet.

M V dhe pak çaste pas tij, Xh N arritën në vendin e ngjarjes. V hyri në makinë dhe u largua me A O dhe personat e plagosur për të marrë ndihmë mjekësore. Ata u takuan me dr I B i cili deklaroi se I O kishte vdekur si pasojë e një palge të shkaktuar nga një armë zjarri. Dr B gjithashtu deklaroi se H kishte marrë një plagë në buzë nga e cila rridhte gjak, me gjasë e shkaktuar nga thyrja e xhamit të dritares. Ai ka vërejtur gjithashtu se fëmija kishte një plagë në kafkë. Dr T Gj ka ekzaminuar Sh disa ditë më vonë duke arritur në përfundimin se fëmija kishte marrë një plagë në kokë. Ai i është nënshtruar një operacioni me datë 17.07.98 dhe më vonë ka dalë nga Qendra Klinike në Prishtinë në gjendje të mirë shëndetësore (Prova 3). Me datë 12.08.00, S O është operuar në një klinikë në Italy (Rajoni Veneto) për të hequr një objekt të huaj prej metali nga shpatulla e tij e djathtë (Prova 4).

Ditën e incidentit më vonë, Gani Gashi u takua me V dhe ai u çarmatos dhe u dërgua në Shtabin e UCK-së.

b) Detaje të tjera të vlerësimit të provave:

1. Vlerësimi dëshmitarëve.

Gjykata konsideron se faktet për të cilat Gani Gashi është dënuar janë vertetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Për të arritur në këtë konkluzion, Gjykata ka konsideruar të gjitha provat dhe ka konsideruar si veçanërisht të pranueshme dëshminë e Xh N mendimet e ekspertit A R, T Gj I B dhe pjesërisht dëshmitë e palëve të dëmtuara, në veçanti A O. Dëshmia e M V, i cili nuk është thirrur si dëshmitar deri në gjykimin kryesor, është interesante por jo shumë relevante si ajo e N sepse V ka arritur në vendin e ngjarjes më vonë.

Dëshmia e A O mbështetet dhe konfirmohet edhe nga gjithë anëtarët e familjes dhe, më e rëndësishmja, nga një dëshmitar i pavarur, Xh N Xh N konfirmon dëshminë e A O në pjesën më të rëndësishme, se makina e viktimave është ndalur kur është dhënë shenja dhe se në atë moment i pandehuri ka pasur një bisëdë të shkurtër me A O. Në dëshminë e tij përpara Trupit Gjykues A O në fillim nuk ka përmendur faktin se ata, pasi janë ndalur dhe biseduar me Gashin, kanë nisur makinën dhe se është shtënë pastaj, pasi që ata janë nisur. Trupi Gjykues konsideron se mospërmendja e këtij fakti thelbësor nga A O është pak e habitshme. Megjithatë, Trupi Gjykues verteton se ky ishte fakti. Kjo mospërmendje nuk ndikon tepër në besueshmërinë e dëshmitarit A O.

Dëshmia e A [REDACTED] R [REDACTED] konsiderohet si dëshmi e rëndësishme dhe Trupi Gjykses konsideron atë të besueshme. Nga kjo dëshmi, Trupi Gjykses ka gjetur se I [REDACTED] O [REDACTED] vdiq për pasojë të një goditje nga një e shtënë me armë zjarri, një plagë depërtuese, “tejkaluere” e cila ka hyrë nga ana e pasme e ulëses, përmes trupit të I [REDACTED] O [REDACTED]. Konkludimi i raportit të autopsisë (Prova 1) i Dr C [REDACTED] dhe R [REDACTED] është se I ndjeri me shumë gjasë kishte marrë të paktën një goditje nga një e shtënë me armë zjarri e drejtuar në pjesën e sipërme të krahavorit dhe të gjitha dëmtimet dhe frakturat e pjesëve të skeletit që janë gjetur në lidhje me plagët/frakturat (nr 2,3,4 dhe 5) e krahavorit janë koherente me plagët perimortem. Shkaku i mundshëm i vdekjes është konsideruar të kenë qenë plagët e shkaktuara nga armë zjarri në krahavor.

Trajektorja e plumbit siç është spjeguar nga R [REDACTED] është në kundërshtim me deklaratën e të pandehurit. Ky i fundit ka deklaruar se ka pasur për qëllim të qëllojë në ajër. Trupi Gjykses konsideron se trajektorja e spjeguar përpara tij nga A [REDACTED] R [REDACTED] është e vërteta, pra se I pandehuri ka pasur për qëllim të qëllojë në personat që gjendeshin në makinë. Trupi Gjykses se trajektorja e treguar nga R [REDACTED] në Gjykatë dhe e treguar në fotografitë e ulëses (prova 6) është në kundërshtim të thellë me spjegimin e të pandehurit se ky i fundit ka tentuar të qëllojë në ajër.

R [REDACTED] ka prezantuar trupit gjykses këmishën e veshur nga I [REDACTED] O [REDACTED] kur ky i fundit ishte i ulur në makinë. Në pjesën e pasme gjendej një vrimë e cila përputhet me plagët e brendshme. Vrima e daljes nuk është gjetur në këmishën e tij, por kjo ndoshta ka ndodhur për faktin se ishte mesi i verës dhe këmisha mund të ketë qenë e hapur.

A [REDACTED] R [REDACTED] ka dëshmuar se predha e cila ka vrarë I [REDACTED] O [REDACTED] kishte shpejtësi të lartë. Plumbi i gjetur në kokën e Sh [REDACTED] nuk ka dëmtuar trurin sepse plumbi nuk kishte shpejtësi të lartë, gjë që do të ishte në përputhje me tezën se e njëjta predhë ka goditur në fillim I [REDACTED] O [REDACTED] dhe pastaj ka goditur kokën e Sh [REDACTED]. Ai ishte i ulur në prehrin e I [REDACTED]. Plumbi që ka goditur S [REDACTED] ka gjasë të ketë qenë i njëjti plumb që ka goditur I [REDACTED]. Ky plumb që ka goditur I [REDACTED] ka pasur shpejtësi të lartë. Meqënëse ai thjesht ka gërvishtur shpatullën e S [REDACTED], ai nuk ka humbur shumë shpejtësi.

2. Vlerësimi i dokumenteve

Trupi Gjykses ka ekzaminuar dokumentet e paraqitura si prova gjatë gjykimit dhe i ka referencuar nën 2. Përmbledhje e provave të paraqitura a-k, që janë në total 11 Prova. Trupi Gjykses konsideron këto dokumente si prova të besueshme dhe ato mbështesin gjetjet e trupit gjykses.

Vlerësim i dëshmisë të të pandehurit

Trupi Gjykses nuk beson dëshminë e të pandehurit. Kjo dëshmi nuk përputhet fare me dëshminë e kolegut të tij, X ■■■■■ N ■■■■■ i cili dëshmoi para Trupit Gjykses. N ■■■■■ tha para Trupit Gjykses se Gashi shkoi afër makinës, ndaloi atje dhe bisedoi me A ■■■■■ O ■■■■■ i cili uli poshtë xhamin e makinës. Gashi tha se kjo nuk ishte aspak e vërtetë. Trupi Gjykses nuk ka arsye të besojë se N ■■■■■ nuk ka thënë të vërtetën. Gashi tha se ai kishte dashur të qëllonte në ajër, por aksidentalisht plumbi shkoi në drejtim të makinës; ai kishte zbuluar vetëm më vonë se në atë makinë ishin viktimat të cilat ai i njihte. Trupi Gjykses nuk konsideron këtë version si të vërtetë. Siç është përmendur më parë, XI ■■■■■ N ■■■■■ konsiderohet si dëshmitar i besueshëm. Për këtë arsye Trupi Gjykses mendon se i pandehuri kishte shkëmbyer disa fjalë me vozitësin e makinës, domethënë ai e dinte se kush ishin personat në makinë. Megjithatë Trupi Gjykses është i mendimit se makina u nis përsëri me shpejtësi pasi kishte ndaluar. Megjithatë arsyeja nuk është provuar. Ndoshta familja O ■■■■■ u frikësua, ndoshta ata i dhanë gaz makinës për një arsye tjetër të cilën ne nuk e dimë.

Vlerësim në lidhje me pranueshmërië e provave:

Avokati mbrojtës ka argumentuar se deklaratat e të pandehurit në polici janë të papranueshme për arsye se janë zhvilluar pa praninë e avokatit mbrojtës.

Trupi Gjykses i përgjigjet këtij argumenti me faktin se këto deklarata nuk janë marrë fare parasysh. Vendimi është bazuar vetëm në provat e paraqitura Trupit Gjykses gjatë gjykimit kryesor nga ana e prokurorisë dhe mbrojtjes ashtu siç janë të renditura në 1. Përmbledhja e provave të paraqitura - pjesë e këtij vendimi (Prova 1-11 (a-k), si dhe dëshmitarët).

4. Vlerësimi ligjor

A. Elementët objektivë

Në Nenin 142, Kodi Penal i SRFJ thuhet se

“Cilido që shkel rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohë lufte, konflikt të armatosur apo pushtim, urdhëron vrasjen e popullatës civile.....ose shkaktimin e vuajtjeve të mëdha apo cënimin e integritetit trupor apo shëndetit,apo cilido që kryen një nga veprat e lartpërmendura, dënohet”

Me qëllim që të vendosen kushtet e kësaj dispozite duhet të përcaktohen rregullat e ligjit ndërkombëtar dhe shkelja e tyre.

Zbatimi i Konventave të Gjenevës në lidhje me këtë rast nuk janë vënë në dyshim. Megjithatë Trupi Gjykues përmend se këto Konventa janë ratifikuar nga Republika Popullore Socialiste e Jugosllavisë më datë 21 prill 1950. Këto Konventa ishin në fuqi në Kosovë duke filluar nga data 22 mars 1989 dhe ishin në fuqi gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë.

Zbatimi e Nenit 3 të Konventës së Gjenevës IV ka qenë subjekt vlerësimi në shumë vendime të mëparshme, kombërate dhe ndërkombëtare.

Mund të flasim për krime lufte dhe zbatimin e konventës së Gjenevës nëse përmbushen tre elemente sipas jurisprudencës së Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë (TNPJ):

- a. Ekzistenca e konfliktit të armatosur
- b. Lidhja midis konfliktit të armatosur dhe krimit të kryer
- c. Statuti i viktimës si person i mbrojtur sipas konventave të Gjenevës

a. Ekzistenca e konfliktit të armatosur

Këtu i referohet vendimeve të TNPJ në Vendimin në lidhje me Juridiksionin në rastin *Tadic* (e cila ishte çështje e Tribunalit për të vendosur juridiksionin e tij sipas Statuteve të tij, megjithatë vlerësimi do të ishte i njëjtë me zbatimin nën Konventat e Gjenevës). “Ekziston konflikt i armatosur kurdo kur kemi përdorim të forcës së armatosur midis Shteteve apo dhunë të armatosur të zgjatur midis organeve qeverisëse dhe grupeve të armatosura të organizuara apo midis grupeve të tilla brenda një Shteti” (*Tadic* para 70).

Në bazë të këtij teksti, me qëllim që të përcaktohet ekzistenca e një konflikti të armatosur me karakter të brendshëm duhet të vlerësohen kriteret e mëposhtme:

- Intensiteti i konfliktit
- Organizimi i palëve

Kriteri përdoret për të nxjerrë në pah ndryshimin midis konfliktit të armatosur dhe banditizmit apo veprimtari të ngjashme të cilat nuk janë subjekt të ligjit humanitar ndërkombëtar dhe për të vendosur nëse krimet e kryera në territorin i cili është nën kontrollin e një prej palëve të parfshira në konflikt përfshihet nga ky përkufizim.

Duke zbatuar këto dy kritere TNPJ ka vendosur në *Limaj et al* (Dhoma, nëntor 2005) para 129 se që në korrik 2008 UÇK është pranuar nga përfaqësuesit ndërkombëtarë, dhe brenda territorit të

Kosovës, si element kyç i përfshirë në negociatat politike për të zgjidhur krizën në Kosovë dhe si rrjedhim është konfirmuar fakti se në atë kohë UÇK-ja, kishte arritur një nivel stabiliteti organizativ dhe efikasitet. Dhoma, e cila njohu këtë, deklaroi se në fund të majit 1998 UÇK-ja posedonte karakteristikat e një grupi të organizuar, në gjendje për t' u angazhuar në një konflikt të brendshëm të armatosur (para 134). Përsa i përket intensitetit aty thuhet (para 154) se nga fundi i majit 1998 kishte raportime mbi sulme të pikave të kontrollit të policisë në Komoran/Komorane, 21 km në perëndim të Prishtina/Pristina. Më tej (para 168) thuhet se aktet e dhunës të cilat ndodhën në Kosovë nga fundi i majit 1998 deri të paktën 26 qershor 1998 nuk ishin përshkruar si të përkohshme, sporadike apo të shpërndara gjeografikisht. Konflikte të armatosura të rregullta ndodhën praktikisht vazhdimisht në intervale kohore midis tre deri shtatë ditësh dhe gjeografikisht të shpërndara përgjatë një territor të gjerë. Dhoma arriti në përfundimin se para fundit të muajit maj 1998 në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur midis forcave serbe dhe UÇK-së (para 171) dhe se ky konflikt i brendshëm vazhdoi shumë kohë pas 26 korrikut 1998 (para 173). Më tej, gjithashtu në *Haradinaj et al* (lënda Nr IT 04-84-T, 3 prill 2008) TNPJ përcaktoi ekzistencën e një konflikti të armatosur nga 22 prill 1998 dhe në vazhdim. Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur se midis 1 majit 1998 dhe 31 gushtut 1998 (*S██████████ K██████████ et al*) në Kosovë ekzistonte konflikti i armatosur midis RFJ-së dhe UÇK-së.

Më tej, në këtë rast, dëshmitarët dhe palët e dëmtuara thana para trupit Gjykues se ata kishin marrë urdhër që të braktisnin shtëpitë e tyre në Komoran për shkak të agresionit të forcave serbe. I██████████ B██████████ X██████████ N██████████ si dhe i pandehuri kanë thënë se UÇK-ja kishte organizuar në atë zonë hapjen e istikameve për të mbrojtur civilët që jëtonin në atë zonë.

Në këtë mënyrë, Trupi gjykues arrin për përfundimin se në periudhën e përmendur në aktakuzën e kësaj lënde ekzistonte konflikt i armatosur.

b. Lidhja midis konfliktit të armatosur dhe krimit të kryer

Në vendimin e Kunarac², TNPJ vendosi se lidhja midis konfliktit të armatosur dhe krimit të kryer mund të përcaktohet nëpërmjet kritereve të mëposhtme: Krimi duhet të ketë lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur, konfliktit të armatosur duhet t' i jetë dhënë mundësia për të vepruar, dhe kryerësi kishte vepruar në cilësinë e ushtarit.

Gjatë gjykimit kryesor është vërtetuar qartësisht se i pandehuri ishte ushtar i UÇK-së. Këtë ai e pranoi vetë gjatë dëshmisë së tij. Komandanti i Njësisë së UÇK-së, M██████████ V██████████ dëshmoi para Trupit Gjykues se dy ushtarët, Gani Gashi dhe Xh██████████ N██████████ atë natë po

² PROSECUTOR v. DRAGOLJUB KUNARAC RADOMIR KOVAC AND ZORAN VUKOVIC, IT-96-23-T& IT-96-23/1-T, trial judgment, page 203, para 568 and 569

përbushnin detyra zyrtare në pikën e kontrollit të UÇK-së. Kompetenca e tyre për të ndaluar trafikun dhe për të kontrolluar makinat bazohej në urdhrat e dhëna nga UÇK-ja. Ekzistenca e konfliktit të armatosura dhe afërsia e forcave serbe në vendin e ngjarjes i dhanë të pandehurit mundësinë për të vepruar.

Në këtë mënyrë, është vërtetuar se Gani Gashi ishte ushtar i UÇK-së, zbatonte detyra zyrtare në emër të UÇK-së. Lufta, e cila ishte në zhvillim e sipër, midis UÇK-së dhe forcave serbe i dhanë mundësinë të pandehurit (detyra e tij në pikën e kontrollit) dhe mjetet (armën) për të kryer krimin.

Shkaku, i cili i dha mundësinë të pandehurit të ndalonte makinën e familjes O [REDACTED] ishte ekzistenca e konfliktit. Konflikti luajti një rol të rëndësishëm në mundësinë e të pandehurit për të kryer krimin, në vendimin e tij për të kryer krimin si dhe mënyrën se si e kreu.

Fakti se ushtari veprroi në emër të tij nuk përfshin faktin se akti nuk mund të konsiderohet si krim luftë.

Si rrjedhojë, Trupi Gjykses ka arritur në përfundimin se lidhja e nevojshme ekziston.

c. Statuti i viktimës si person i mbrojtur në bazë të Konventave të Gjenevës

Anëtarët e familjes O [REDACTED] ishin civilë. Ata nuk morrën asnjëherë pjesë në veprimet ushtarake. Ata kishin veshur rroba civile dhe nuk kishin armë. Fakti se disa persona kishin pranuar të hapnin istikame nuk ndikon në statusin e tyre në kohën e kryerjes së veprës penale. Sipas jurisprudencës së TNPJ-së dhe Gjykatës Supreme të Kosovës (*I [REDACTED] G [REDACTED] et al* 21.07.2005) nuk është e domosdoshme që ata të kenë të njëjtën kombësi si armike që të përfitojnë statusin e

Pra, Trupi Gjykses ka arritur në përfundimin që viktimat të kenë statusin e nevojshëm të personave të mbrojtur.

*

Meqënëse janë përbushur tre elementët e domosdoshëm për përcaktimin e një krimi si krim luftë dhe shkeljen e ligjit ndërkombëtar, atëherë janë përcaktuar elementët objektivë të veprës penale.

B. Elementët subjektive

a) Përgjegjësia penale

Në pajtim me Neni 11 paragrafi 1 KP RSFJ, i pandehuri është penalisht i përgjishëm nëse ai ishte përgjegjës (neni 12) dhe ka kryer veprën penale me paramendim apo neglizhencë. Më tej, në pajtim me Nenin 13 KP RSFJ, kemi të bëjmë me paramendim në rastet kur *“vepra penale është e paramenduar nëse kryerësi është i ndërgjegjshëm për veprimin e tij dhe dëshiron kryerjen e tij; apo kur ai është i ndërgjegjshëm se si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të tij mund të ketë pasoja të ndaluara, dhe miraton kryerjen..”*

Përkufizimi i “paramendimit” i korrespondon termit juridik “dashje”, shih më poshtë.

Neni 12 nuk zbatohet pasi nuk ka prova se i pandehuri nuk ishte në gjendje të kuptonte rëndësinë e akteve të tij dhe se zotësia e tij gjithashtu nuk ishte zvogëluar dukshëm.

b) Mens rea

Nën Konventën e Gjenevës IV të 1949 neni 146 dhe 147 Konventa detyron palët Kontraktuese të ndërmarrin dhe dekretojnë legjislacionin e nevojshëm për të siguruar sanksione penale efektive kundër, psh vrasje me dashje and shkaktimi, me dashje, i lëndimeve të rënda të trupit apo shëndetit. Neni 142 KP RFSJ dhe Neni 11 KP RFSJ, në lidhje me Nenin 13 KP RSFJ parashtrajnë kushtet e paramendimit. Kjo ka të njëjtën kuptim si qëllimi kriminal (mens rea) dhe veprimin me dashje si një kusht. Nuk ka tregues se kushtet e Nenit 142 është një formë e zbutur e qëllimit. Ky kusht do të ishte në kundërshtim me Konventën dhe nuk gjen mbështetje në asnjë sistem ligjor. Edhe një formë më e lehtë e qëllimit (dolus eventualis) (pakujdesia) duhet të përfshihet në kushtet e mens rea të Konventave (ref. International Criminal Laë, Antonio Cassese, Oxford University Press 2003 p. 58).

Në këtë mënyrë, duhet të vërtetohet se i pandehuri veprroi me qëllimin për të vrarë. Ky qëllim është shumë i qartë nga fakti se ai qëlloi makinën pasi kjo e fundit kishte ndaluar dhe gjithashtu nga mënyra se si qëlloi. Ai nuk qëlloi në ajër, siç kërkohej nga udhëzimet e Komandantit por direkt në makinë. Këtë e tregon edhe trajektorja e plumbit. Kjo mbështetet nga forma e trajektores, goditja dhe depërtimi i ulëses lart dhe dalja poshtë në anën e majtë, dhe e njëjta ndodhi edhe për trajektoren depërtuese përmes trupit të [REDACTED] O [REDACTED]. Trajektorja është në pajtueshmëri me qëllimin për të vrarë, duke marrë parasysh se i pandehuri ishte në këmbë dhe se viktimat ishin të ulura në makinë edhe nëse makina lëvizte përpjetë. Nëse ai ka qëlluar në ajër kjo është në mospajtueshmëri të plotë me mënyrën se si plumbi është shtënë. I pandehuri duhet të ketë qenë të paktën në dijeni të pasojave të mundshme të sjelljes së tij, duke qenë në dijeni se po rrezikonte shkaktimin e pasojave të tilla.

Ai duhet të ketë parashikuar apo pranuar rrezikun se sulmi kishte mundësi të shkaktohte humbjen e jetës dhe plagosjen e personave.

Meqënëse i pandehuri foli me A [redacted] O [redacted] ai e dinte se kush ishin viktimat dhe se ata ishin civilë; ai qëlloi me qëllimin e qartë për t'i vrarë ata, për motivin, të cilin Trupi Gjykses akoma nuk e ka përcaktuar.

c) Zbatimi i nenit 142 KP RFSJ

Neni 3 paragrafi (1) (a) i Konventës së Gjenevës thotë se

“.....veprat në vijim janë dhe mbesin të ndaluara në çdo kohë

a) Dhuna kundër jetës dhe personave, në veçanti vrasjet e çdo lloji,.....”

Gjithashtu neni 142 i KP RFSJ thotë se kushdo që kryen vrasje apo dhunim të integritetit trupor apo shëndetësor dënohet në pajtim me nenin e përmendur.

Duke u bazuar në gjetjet faktike të trupit Gjykses, Gani Gashi ka vrarë me dashje I [redacted] O [redacted], ai ka kryer vrasje në tentativë me dashje kundër të miturit Sh [redacted] O [redacted] dhe ka shkaktuar dhunimin e integritetit trupor dhe shëndetësor të H [redacted] dhe S [redacted] O [redacted]. Me këto veprime ai ka përmbushur elementet subjektivë të nenit 142 të KP RFSJ.

**

Kështu, kjo Gjykatë vlerëson se elementet objektivë dhe subjektivë nga neni 142 KP RFSJ janë vertetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

C . Vlerësimi dhe përlllogaritja e dënimit.

a) Ligji i Zbatueshëm.

Në pajtim me nenin 4 (2) të KP RFSJ zbatohet ligji më i favorshëm. Kështu, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë cili është ligji më i favorshëm për të pandehurin: ai në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale apo ai në fuqi në momentin e gjykimit.

Krimi është kryer në vitin 1998, kur në fuqi ishte Kodi Penal i Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë (KP RFSJ) prej 1976. Gjatë kësaj periudhe kohore që nga kryerja e krimin, kanë ndryshuar disa dispozita penale. Në vitin 2004 ka hyrë në fuqi Kodi i ri Penal i Kosovës. Krimet e luftës parashihen gjithashtu nga Kodi i ri, në nenin 121, dënimi maksimal i paraparë është 40 vjet burg.

Në pajtim me Kodin e vjetër, në fuqi në kohën e ngjarjeve, dënimi maksimal i paraparë për krime lufte ishte dënimi me vdekje. Megjithatë, Trupi Gjykses duhet të konsiderojë rregulloret e UNMIK-ut 1999/24 dhe 2000/59. E para shfuqizon dënimin me vdekje. E dyta

vendos një dënim maksimal prej 40 vjet burgim për krimet për të cilët parashihej dënimi me vdekje.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59 parasheh se kjo rregullore zbatohet vetëm për krimet e kryera pas datës 27 tetor 2000. Kështu, për krimin e kryer në korrik të vitit 1998, aplikohet kodi i vjetër i Jugosllavisë (KP RFSJ). Megjithatë, Trupi Gjykses duhet të marrë parasysh rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 e cila shfuqizon dënimin me vdekje. Kështu, ligji i zbatueshëm për krimin e kryer në korrik të vitit 1998 është kodi i vjetër i lidhur me rregulloren e UNMIK-ut 1999/24. Në bazë të kësaj, neni 38 paragrafi 2 i kodit të vjetër bëhen të zbatueshëm, pra kryesi mund të ngarkohet me një maksimum prej 20 vjetësh meqënëse dënimi me vdekje është shfuqizuar dhe dënimi alternativ, zëvendësues është 20 vjet në vend të mos zbatimit të dënimit prej 40 vjetësh të paraparë nga Rregullorja. 00/59.

b) Përlllogaritja e dënimit.

Duke marrë parasysh nenin 38 të KP RFSJ (dispozita i referohet gabimisht KPPK-së) Trupi Gjykses ka shqiptuar dënimin prej 17 vjetësh siç është përmendur më lart.

Trupi Gjykses ka marrë parasysh të gjitha rrethanat në shqiptimin e dënimit. I pandehuri kishte në posedim një armë automatike në gjendje të shkaktonte plagë të mëdha apo humbje të jetës së personave. I pandehuri ka shtënë duke qenë në dijeni se shënjestra e tij ishte një numër i madh personash dhe se ata ishin civilë. Ai ka keqpërdorur pozitën e tij si ushtar i UCK-së me qëllim që të kryejë krimin. Ai ka keqpërdoruar besimin që civilët kanë pasur në personat e veshur me uniforma të UCK-së dhe në këtë mënyrë do të kishte qenë e pamundur për civilët që të mbroheshin. Gjithashtu, i pandehuri nuk ka marrë parasysh faktin se në makinën e viktimave gjendeshin dy të mitur, dy fëmijë gjashtë vjeçarë, si dhe dy persona të moshuar.

I pandehuri nuk i është nënshtruar asnjë udhëzimi standart të dhënë nga komandanti i tij i cili ka dëshmuar përpara Trupit Gjykses duke thënë se ai nuk do të kishte urdhëruar kurrë dhe askënd të qëllojë më armë civilë si në këtë rast.

Të gjitha këto rrethana janë konsideruar nga anëtarët e Trupit Gjykses si rrethana rënduese duke shqiptuar kështu dënimin prej 17 vitesh burgim që është afër dënimit maksimal të paraparë me ligj.

Fakti se makina është nisur pasi ajo është ndalur nuk jep arsye për të zbutur dënimin si rrethanë zbutëse sepse fakti mbi të cilin kjo gjë mbështetet nuk është vertetuar.

5. Kërkesë për dëmshpërblim.

Palët e dëmtuara janë informuar mbi të drejtat e tyre për të parashtruar një kërkesë për dëmshpërblim në pajtim me nenin 107 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, megjithatë nuk janë parashtruar kërkesa të tilla deri në fund të gjykimit në pajtim me nenin 109 paragrafi 2.

6. Shpenzimet

I pandehuri Gani Gashi do të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale. Në pajtim me nenin 100 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale një vendim i ndarë do të merret në lidhje me këtë.

3 Mars 2009

Kryetari i Trupit Gjykses

Tron GUNDERSEN

Anëtarë i Trupit Gjykses

Andrea CRUCIANI

Anëtarë i Trupit Gjykses

Zahide GJONAJ

Procesmbajtëse

Elisabeth BATMAN

Mjete Ligjore

Në pajtim me nenin 400 (1) të KPPPK-së, ankesa duhet të paralajmërohet brenda një afati prej 8 ditësh nga shpallja e këtij aktgjykimi dhe në pajtim me nenin 398 (1) të KPPPK-së, ankesa mund të parashtrohet kundër aktgjykimit të kësaj Gjykate brenda 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.

100

100

100